



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



**Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve**  
**Nacionalni Autoritet za Kualifikacije**  
**National Qualification Authority**

Numër: 323/01  
Datë: 29.06.2017

Në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe neneve 4, 5, 6, të Udhëzimit Administrativ Masht Nr: 28/2014 për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 26.05.2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohen raportet e jashtme të verifikimit të standardeve të profesionit së bashku me të gjitha rekomandimet e panelit të ekspertëve si Standarde Kombëtare të Profesionit me këta emra dhe kode:

- Policët/ policet, me kodin 5162 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK;
- Inspektorët e policisë dhe detektivët, me kodin 3355 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK;
- Ndihmës Kuzhinier, me kodin 9412 dhe me nivelin III të kualifikimit sipas KKK;
- Banakier në restaurant, kafene, bar, etj. me kodin 5132 dhe me nivelin III të kualifikimit sipas KKK;
- Bërës ëmbëlsirash, me kodin 7512 dhe me nivelin III të kualifikimit sipas KKK;
- Picamen, me kodin 9411 dhe me nivelin III të kualifikimit sipas KKK.

2. Raportet e jashtme të verifikimit të standardeve të profesionit duhet t'iu dërgohen KAAPRr dhe zhvilluesit të standardit të profesionit në fjalë.

3. Nuk aprovohen si Standarde Kombëtare të Profesionit duke u bazuar në raportet e jashtme të verifikimit të standardeve të profesionit së bashku me të gjitha rekomandimet e panelit të ekspertëve këto dy standarde të profesionit:

- Recepcionist, dhe
- HACCP.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.

  
Kryetari i KD së AKK-së  
Bedri Xhafa

